

# **NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA**

## **BASHKIA TIRANË**

NJOFTIM FITUESI  
(MINIKONKURS)

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SHANSI INVEST” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk  
Adresa: Tirane Rruga Reshit Çollaku, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7; Elbasan Gramsh SPORTI.

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit  
Procedura e prokurimit: **“Riaftësimi strukturor i ndërtesës Nr.13, Rruga Ferit Xhajko”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-40357-08-31-2022

Fondi limit për objektin **“Riaftësimi strukturor i ndërtesës Nr.13, Rruga Ferit Xhajko”**, është 33,528,284.51 (tridhjetë e tre milion e pesëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër pike pesëdhjetë e një ) lekë pa TVSH.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 43; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VI, Neni 48, si dhe Kreu VII, Neni 59, si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 07 datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” shpk & “BE - IS” shpk
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “IGROUP” shpk & “DAJTI PARK 2007” shpk & “ALTEC” shpk
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “K A C D E D J A” shpk & “EVEREST” shpk
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk & “RAFAELO 2002” shpk & “ARB & TRANS-2010” shpk

5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “KUPA” shpk & “LIQENI VII” ShA & “ALB - EDIL” shpk
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” shpk & “JUNIK” shpk & “NIKA” shpk
7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SHANSI INVEST” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SHANSI INVEST” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk  
NUIS J61924002T & NUIS K47103804L

Oferta ekonomike = 33,369,837 (tridhjetë e tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” shpk & “JUNIK” shpk & “NIKA” shpk

NUIS L42215009L & NUIS J68007522L & NUIS J76705047U

Oferta ekonomike = 33,479,501.62 (tridhjetë e tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e një pikë gjashtëdhjetë e dy ) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” shpk & “BE - IS” shpk  
NUIS K02727229P & NUIS K71412003A

Oferta ekonomike = 33,472,682.5 (tridhjetë e tre milio e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “IGROUP” shpk & “DAJTI PARK 2007” shpk & “ALTEC” shpk  
NUIS M01406012K & NUIS K11507003S & NUIS K57923807Ë

Oferta ekonomike = 38,528,386 (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “IGROUP” shpk & “DAJTI PARK 2007” shpk & “ALTEC” shpk.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “IGROUP” shpk & “DAJTI PARK 2007” shpk & “ALTEC” shpk nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas Fteses për Oferte. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka dorëzuar dokumentet si më poshtë:

- Formulari i Sigurimit te Ofertes
- Metodologjinë e punes
- Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve Teknike (Shtojca 8);
- Grafiku i punimeve

Oferta ekonomike e paraqitur është në vlerën është në vlerën 38,528,386 lekë pa TVSH, pra mbi fondin limit për këtë objekt minikonkursi, cka bie në kundërshtim me kërkesat e ftesës për ofertë “ Çdo ofertë e paraqitur mbi fondin limit për këtë minikonkurs do të skualifikohet”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e operatorëve ekonomikë “SHANSI INVEST” shpk & “VIANTE KONSTRUKSION” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, konkretisht Bashkimit të Operatorëve ekonomik “ERGI” shpk & “BE-IS” shpk i vlerësuar me 99,81 pikë.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 05 / 07 / 2024

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.